



FLETORJA ZYRTARE

E REPUBLIKËS SË

SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 126

Tiranë – E premte, 25 gusht 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 2.8.2023	Për mënyrën e gjenerimit dhe të përdorimit të të ardhurave të siguruara nga ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional..... 15099
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 24, datë 4.8.2023	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 14, datë 27.5.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar..... 15102
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 227, datë 14.7.2023	Mbi miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit, marrëveshjen e operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018..... 15102
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 319, datë 12.12.2022	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..... 15108
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 27, datë 7.8.2023	Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023..... 15110
	Korrigjim gabimi në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 27.3.2023, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 150, datë 10.6.2022, ‘Mbi miratimin e Zyrtarit të Pajtueshmërisë të ‘Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)’ sh.a.’”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 4.5.2023..... 15115

**UDHËZIM****Nr. 23, datë 2.8.2023****PËR MËNYRËN E GJENERIMIT DHE
TË PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE
TË SIGURUARA NGA OFRUESIT
PUBLIKË TË ARSIMIT DHE FORMIMIT
PROFESIONAL**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 30, të ligjit nr. 15, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, ministri përgjegjës për financat dhe aftësimin dhe formimin profesional,

UDHËZON:**I. TË PËRGJITHSHME**

1. Ky udhëzim ka për qëllim rregullimin e mënyrës së gjenerimit (realizimit) dhe të shpenzimit të të ardhurave të realizuara nga veprimtaria (aktivitetet) e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional.

2. Ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional veprojnë si njësi ekonomike, për të siguruar të ardhura nga aktivitetet e praktikave mësimore.

3. Në kuadër të veprimtarisë së ofruesve të AFP-së, realizimi, menaxhimi dhe përdorimi i të ardhurave të gjeneruara nga veprimtaria ekonomike e ofruesit publik të arsimit dhe formimit profesional, administrohen në llogarinë ekonomike të të ardhurave të ofruesve, me sistem të plotë të menaxhimit të fondeve pranë degëve të thesarit.

II. GJENERIMI I TË ARDHURAVE**2.1 Mënyrat e kryerjes së veprimtarisë fitimprurëse**

1. Aktiviteti për gjenerimin e të ardhurave të ofruesve publikë të AFP-së realizohet vetëm në fushat që kanë lidhje me programet dhe praktikat mësimore që ofron institucioni i AFP-së dhe realizohet vetëm në funksion të tyre. Veprimtaria fitimprurëse nuk duhet të përbëjë qëllim në vetvete.

2. Kryerja e aktiviteteve ekonomike të ofruesve të AFP-së nuk duhet të cenohet në asnjë aspekt veprimtarinë normale të institucionit, në përputhje me qëllimin dhe objektivat e tij, por përkundrazi duhet të shërbejë për përmirësimin e ofertës së institucionit.

3. Kryerja e aktiviteteve ekonomike të ofruesve të AFP-së bëhet në bazë të buxhetit të planifikuar për ofruesin dhe në përputhje me planifikimin e përgjithshëm të të ardhurave dhe mënyrën e të përdorimit të tyre, të miratuar nga bordi drejtues.

4. Kryerja e veprimtarisë ekonomike të ofruesve të AFP-së konsiderohet vetëm nëse institucioni ka burime njerëzore të mjaftueshme dhe infrastrukturë të përshtatshme, që mundëson kryerjen e saj në mënyrë të përshtatshme dhe në përputhje me përcaktimet ligjore e kontraktuale.

5. Në çdo rast të ardhurat e realizuara nga veprimtaria ekonomike, në parim, duhet të mbulojnë shpenzimet e kostot që lidhen me ofrimin e shërbimit apo prodhimin e produkteve (nga praktikat mësimore të nxënësve) dhe me një marzh të vogël fitimi.

2.2 Standardet e ofrimit të shërbimeve dhe mallrave

1. Veprimtaria ekonomike e ofruesve të AFP-së bazohet në parimin e sigurimit të cilësisë, për sa i përket cilësisë së shërbimeve dhe produkteve të ofruara në këtë kuadër.

2. Veprimtaria ekonomike e ofruesve të AFP-së kryhet vetëm mbi bazën e kontratave me shkrim, të nënshkruara me personat fizikë dhe juridikë, në të cilat përcaktohen në mënyrë të qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe termat e tjera të bashkëpunimit.

3. Të gjitha fazat e kryerjes së veprimtarisë ekonomike të ofruesve të AFP-së janë objekt auditimi nga strukturat përkatëse brenda vetë institucionit dhe jashtë tij.

2.3. Aktivitetet fitimprurëse të ofruesve të AFP-së

1. Veprimtaria ekonomike e ofruesve të AFP-së realizohet në formën e ofrimit të shërbimeve dhe/ose shitjes së mallrave.

2. Të ardhurat e realizuara nga shërbimet dhe shitja e produkteve përfshijnë:

a) të ardhura nga oferta e AFP-së;

i. pagesat e kursanteve për ndjekjen e kurseve të formimit profesional;

ii. pagesat e individëve për njohjen e të nxënësve të mëparshëm, kur ofruesi është akredituar për një aktivitet të tillë sipas akteve ligjore për të nxënësin e mëparshëm;

b) të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve dhe shitja e produkteve të prodhuara e përfutuara në kuadër të praktikave mësimore e profesionale;



c) të ardhurat nga dhënia me qira e mjediseve dhe pajisjeve, bazuar në kontrata qiraje ose kontrata të tjera, sipas VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar;

d) fondet e përfituara në kuadër të projekteve lokale/kombëtare, si dhe projekte të financuara nga donatorë ndërkombëtarë;

e) të ardhura të tjera që lejohen me ligj.

3. Të ardhurat e lart përmendura janë në përputhje me qëllimet e institucionit, lidhen me kualifikimet e ofruesve dhe me qëllimet sociale dhe nuk duhet të përbëjnë qëllim fitimi në vetvete.

2.4 Përcaktimi i tarifave dhe çmimeve për produktet e ofruara

1. Për të ardhurat nga oferta e AFP-së, ku përfshihen kurset e trajnimit, tarifa/pagesa bazohen në analizën e kostos sipas profilit të kursit.

2. Pagesa (tarifa) për shërbimet e ofruara, në kuadër të veprimtarisë ekonomike të ofruesve të AFP-së, bazohet në analizën e kostos për shërbimet që ofron në kuadër të praktikave mësimore.

3. Çmimet për produktet/mallrat e prodhuara, në kuadër të veprimtarisë ekonomike të ofruesve të AFP-së, mbështeten në analizën e kostos për realizimin e këtyre produkteve.

4. Tarifat (pagesa për shërbimin) për shërbimet e ofruara dhe çmimet për produktet/mallrat e ofruara duhet të jenë në koherencë me tregun dhe në asnjë rast nuk duhet të jenë në konkurrencë me çmimet e tregut lokal apo rajonal.

5. Tarifat për shërbimet e ofruara, çmimet për produktet/mallrat e ofruara, i propozohen bordit drejtues të ofruesit të AFP-së, nga një komision i përbërë nga drejtori i ofruesit publik, përgjegjësi i njësisë së zhvillimit, si dhe përgjegjësi i njësisë së shërbimeve financiare.

6. Tarifat (pagesa për shërbimin) për shërbimet e ofruara dhe çmimet për produktet/mallrat e ofruara, në kuadër të veprimtarisë ekonomike të ofruesve të AFP-së, miratohen me vendim nga bordi drejtues i

ofruesit të AFP-së dhe bëhen publike në faqen e institucionit.

III. PËRDORIMI I TË ARDHURAVE

1. Të ardhurat e realizuara, në kuadër të veprimtarisë ekonomike të ofruesve të AFP-së, arkëtohen në adresë të institucionit me faturën për arkëtim, sipas modelit të miratuar me urdhrin e ministrit të Financave nr. 35, datë 11.11.2009, aneksi 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe është pjesë e tij.

2. Të ardhurat e gjeneruara/realizuara nga ofruesit e AFP-së administrohen 100% nga vetë ofruesit e AFP-së, dhe përdoren si të ardhura jashtë limiti, të cilat mbarten në vitin buxhetor pasardhës.

3. Të ardhurat e realizuara gjatë vitit ushtrimor përdoren në përputhje me rregullimet e përshtuara në këtë udhëzim dhe procedurave ligjore në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

4. Të ardhurat e realizuara përdoren nga ofruesit e AFP-së, sipas përcaktimeve si më poshtë:

a) deri në masën 10% të të ardhurave vjetore, përdoren për pagesën e punonjësve të angazhuar (jo në organik) në këto veprimtari;

b) deri në masën 40% të të ardhurave vjetore, përdoren për mbulimin e kostove operative të veprimtarisë ekonomike të ofruesve të AFP-së;

c) deri në masën 50% të të ardhurave vjetore, përdoren për shpenzime kapitale/investime.

5. Të ardhurat e realizuara nga projekte lokale/kombëtare, si dhe të projekteve të financuara nga donatorë ndërkombëtarë përdoren sipas përcaktimeve përkatëse në kontratën e nënshkruar.

IV. DISPOZITAT E FUNDIT

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi ofruesit publikë të AFP-së, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe degët e thesarit në rrethe.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj



ANEKS 1

FATURË PËR ARKËTIM

Nr. _____, datë _____

BANKËS _____

dhe shumat si më poshtë:

Kodi i institucionit:

Kodi i degës së thesarit ku vepron:

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave		Shuma që arkëtohet (lek)
	Emërtimi	Kodi i llogarisë ekonomike	
1			
2			
3			
4			
5			
	TOTALI		

INSTITUCIONI

Përgjegjës i sektorit të financës

KLIENTI

*(emër mbiemër)**Adresa:**Kontakti:*



UDHËZIM

Nr. 24, datë 4.8.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 27.5.2021, “PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL, SI DHE ASPEKTET E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, PËRBËRJES SË NJËSISË SË ZHVILLIMIT TË OFRUESVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË PERSONELIT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të neni 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neni 12, pika 4 dhe të neni 15, pika 3, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 14, datë 27.5.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Në kreun XVII, “Procedurat e marrjes në punë të personelit drejtues të ofruesit të AFP-së”, neni, 69, pika 2, shkronja “a”, ndryshon si më poshtë:

“ a) të ketë diplomë të studimeve universitare master shkencor ose të barasvlershëm me të;”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

VENDIM

Nr. 227, datë 14.7.2023

MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN E PROCEDURAVE PËR LIDHJET E REJA DHE MODIFIKIMIN E LIDHJEVE EKZISTUESE ME RRJETIN E TRANSMETIMIT, MARRËVESHJEN E OPERIMIT NË RRJETIN E TRANSMETIMIT NDËRMJET OST SHA DHE PËRDORUESIT, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 87, DATË 20.4.2018

Në zbatim të neneve 10, pika 2, 16, 20, germa “h” dhe 27, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të neni 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.7.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1041/3 prot., datë 21.6.2023 dhe informacionin shtesë me nr. 1041/1 prot., datë 12.7.2023, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit, marrëveshjen e operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018”,

konstatoi se:

- Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., nëpërmjet komunikimit me *email* të datës 27.3.2023, ka parashtruar se palët kanë rënë dakord për ndryshimet në marrëveshjen tip të lidhjes, të cilat janë ato të përcjella nga konsulenca e MIE-s në ERE, nëpërmjet postës elektronike, më datë 15.2.2023, me lëndë: “Për vlerësimin dhe pranimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen standarde të lidhjes, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 120, datë 4.4.2023, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e ndryshimeve në rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit, marrëveshjen e operimit në rrjetin e transmetimit



ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018.

- ERE, me shkresën nr. 1223 prot., datë 11.4.2023, i dërgoi njoftim për fillimin e procedurës, lidhur me vendimin nr. 120/2023, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL) sh.a. dhe Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) sh.a.

- ERE, më datë 13.4.2023, publikoi në faqen zyrtare të internetit, në rubrikën konsultime, draftin e propozuar të ndryshimeve në marrëveshjen e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit, për komente apo sugjerime nga të gjitha palët e interesit.

- Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 2273 prot., datë 24.4.2023, ka përcjellë në ERE propozimin lidhur me disa ndryshime në “Rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit, marrëveshjen e operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018, duke bërë me dije se propozimi vjen në zbatim të përcaktimeve të “Kodit të ri të Transmetimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 63, datë 11.4.2022.

- Për sa më sipër, nga ERE u vlerësua e rëndësishme që OST sh.a. të ketë një qëndrim përfundimtar për këtë çështje. Për këtë qëllim, ERE, me shkresën nr. 1315/1 prot., datë 12.5.2023, i ka kërkuar OST sh.a. dhënien e një qëndrimi përfundimtar lidhur me propozimet e bëra.

- OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 2273/2 prot., datë 22.5.2023, protokolluar në ERE me nr. 1315/2 prot., datë 23.5.2023, parashtroi se: “e gjykon të nevojshme të kërkojë pezullimin e shqyrtimit nga ERE dhe të tërhiqet nga propozimet e bëra me shkresën nr. 2273 prot., datë 24.4.2023 dhe OST sh.a. do të vijoi më tej punën për plotësimin e akteve të nevojshme të përcaktuara në vendimin e Bordit të ERE nr. 63, datë 11.4.2022, për miratimin e “Kodit të Transmetimit””.

- Në vijim të komunikimit, lidhur me procedurën e filluar nga ERE me vendimin nr. 120, datë 4.4.2023, OST sh.a., me *email*-in e datës 29 maj 2023, ka dërguar të ripunuara amendimet e marrëveshjes

së lidhjes, me korrektime respektive, për të cilat është rënë dakord midis palëve.

- Më datë 23.6.2023, u publikua në rubrikën konsultime, në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, drafti me ndryshimet/sugjerimet e OST sh.a., i dërguar me *email*-in e datës 29 maj 2023, me qëllim që të aksesohet nga të gjithë palët e interesit.

- ERE, nëpërmjet shkresës nr. 1859 prot., datë 29.6.2023, njoftoi palët e interesit, të cilat ishin njoftuar me shkresën nr. 1223 prot., datë 11.4.2023, për fillimin e procedurës lidhur me vendimin nr. 120/2023, duke i bërë me dije se drafti i ripunuar gjendet i publikuar në seksionin “Konsultime” në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, www.ere.gov.al. Asnjë nga palët e interesit nuk ka dhënë ndonjë vlerësim/koment lidhur me këtë dokument.

- Nga shqyrtimi i ndryshimeve të sjella nga shoqëria OST sh.a. në ERE, nëpërmjet *email*-it të datës 29 maj 2023, vlerësohet që në nenin 13, të shtohet pika 16, me përmbajtje: “16. OST sh.a. në çdo rast do të dokumentojë dhe publikojë kostot e shkaktuara si pasojë e një ngjarjeje të ndërprerjes, si dhe do të publikojë kompensimet si pasojë e një ngjarjeje të de-energizimi. Ky përkufizim përfshin publikimin e kostove në rastet e ndërprerjeve të parashikuara në pikën 15, të nenit 13, por dhe publikimin e dokumentacionit të kompensimeve në rastin e de-energizimit, parashikuar në pikën 9, të nenit 13, të marrëveshjes së operimit me rrjetin e transmetimit.”.

- Ndryshimet e propozuara në nenet 1, 3, 4, 6, 8, 9, 10, 13 (i ndryshuar), 19 dhe 23, vlerësohet se garantojnë sistemin e operimit të rrjetit të transmetimit, përshtatjen me kushtet aktuale të sektorit për diversifikimin e prodhimit të energjisë elektrike dhe janë me karakter përmirësues të marrëdhënies midis OST sh.a. dhe përdoruesit, duke evidentuar kostot dhe kompensimet si pasojë e ngjarjeve të shkaktuara në rrjetin e transmetimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit, marrëveshjen e operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018 (bashkëlidhur ndryshimet e miratuara).



2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë OST sh.a. dhe palët e tjera të interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

**Miraturar me vendimin e Bordit të ERE-s
nr. 227, datë 14.7.2023**

**NDRYSHIMET E MIRATUARA NË
MARRËVESHJEN E LIDHJES ME RRJETIN E
TRANSMETIMIT NDËRMJET OPERATORIT
TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT OST SHA
DHE PËRDORUESIT**

1. Neni 1, paragrafi 2, i marrëveshjes së lidhjes me rrjetin ndryshon dhe bëhet:

“Me anekse do të kuptojmë:

a) Aneksi nr. 1: Dokumentacioni teknik i lidhjes me Rrjetin Kombëtar të Transmetimit;

b) Aneksi nr. 2: Licenca për prodhimin e energjisë elektrike, e lëshuar nga ERE ose aplikimi pranë ERE-s për t'u pajisur me një licencë për prodhimin e energjisë elektrike;

c) Aneksi nr. 3: Specifikimet teknike të sistemit të matjes tregtare;

d) Aneksi nr. 4: Specifikimet teknike të lidhjes me sistemin e telekomunikacionit;

e) Aneksi nr. 5: Specifikimet teknike të lidhjes me sistemin SCADA të Qendrës Kombëtare Dispeçer;

f) Aneksi nr. 6: Deklaratat e përgjegjësisë dhe gatishmërisë;

g) Aneksi nr. 7: Pjesët e aseteve të lidhjes që do të dorëzohen;

h) Në rast konflikti, ndërmjet përcaktimeve të bëra në anekset e kësaj kontrate dhe dispozitave të mëposhtme, këto të fundit do të mbizotërojnë.”.

2. Në nenin 1 (anekset dhe përkufizimet), paragrafi 3 i marrëveshjes së lidhjes me rrjetin, shtohen përkufizime të reja dhe ndryshojnë përkufizimet ekzistuese si më poshtë:

““Akt” nënkupton çdo ligj, vendim të Këshillit të Ministrave, udhëzim të ministrave ose të organeve publike rregullatore ose jo, të veshura me kompetenca për të nxjerrë akte me qëllim rregullimin e një fushe të caktuar, të cilët kanë efekt mbi veprimtarinë e palëve dhe veçanërisht mbi fushën objekt i kësaj marrëveshje.

“Energjia e prodhuar” nënkupton energjinë të injektuar në rrjetin e transmetimit të OST sh.a. në pikën e matjes, siç matet në përputhje me Kodin e Matjes dhe kësaj marrëveshje të lidhjes.

“Marrëveshje” nënkupton këtë marrëveshje të lidhur midis përdoruesit dhe OST-së, me qëllim përcaktimin e kushteve për lidhjen dhe përdorimin e rrjetit kombëtar të transmetimit të energjisë elektrike nga përdoruesi.

“Ngjarje e ndërprerjes” nënkupton çdo ndërprerje në rrjetin e transmetimit ose de-energizim të impiantit që nuk lejon përdoruesin të injektojë energjinë elektrike plotësisht ose pjesërisht në pikën e lidhjes, që është si rezultat i çdo sjelljeje me dashje ose nga pakujdesia të OST sh.a., ose shkelje nga OST sh.a. të dispozitave të ligjit të zbatueshëm, të kodit të rrjetit apo kësaj marrëveshjeje.

“Përdorues” nënkupton personat fizikë ose juridikë të cilët furnizojnë me ose të cilët furnizohen me energji elektrike nëpërmjet rrjetit të sistemit të transmetimit.

“Objekti” Impiant gjenerimi ose ngarkese.

“Impianti [hidro] [solar] [erë] [burime të tjera të rinovueshme]” [në rastin e marrëveshjeve të lidhjes me impiant gjenerimi] nënkupton, hidrocentralin që do të ndërtohet nga përdoruesi. [Në rastin e marrëveshjeve të lidhjes me impiant gjenerimi] nënkupton impiantin fotovoltaiq që do të ndërtohet nga përdoruesi. [Në rastin e marrëveshjeve të lidhjes me impiant gjenerimi] nënkupton impiantin e erës që do të ndërtohet nga përdoruesi. [Në rastin e marrëveshjeve të lidhjes me impiant gjenerimi] nënkupton impiante nga burime të tjera të rinovueshme që do të ndërtohet nga përdoruesi.



“Asetet e lidhjes” nënkupton asetet e lidhjes (linja, nënstacioni, elemente të tjera lidhëse), që do të ndërtohen nga përdoruesi, për të lidhur centralin prodhues/konsumator të energjisë elektrike me rrjetin e transmetimit siç është paraqitur në aneksin nr. 1.

“Nënstacion” nënkupton nënstacionin.../... kV që do të ndërtohet nga përdoruesi afër ... (hidrocentralit /impianitit fotovoltai/impianitit të erës me fuqi transformatori ... mVa.

“Pika e Lidhjes” nënkupton pikën ku objektet lidhen me rrjetin e transmetimit, që përcakton vendin e saktë të lidhjes me rrjetin e transmetimit (hyrje–dalje në linjë, lidhje në zbara, etj.).

“Pika e Matjes” nënkupton pikën ku matet energjia elektrike që përdoruesi injekton në/merr nga rrjeti i transmetimit që është i instaluar në anën e tensionit të lartë të transformatorit të fuqisë.

“Komisionim” nënkupton procesin e testimit, kontrollit dhe kolaudit të aseteve të lidhjes (nënstacionit TL/TM dhe pjesës së linjës lidhëse), për të plotësuar kushtet dhe përcaktimet e parashtruara nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit.

“Licenca” nënkupton në çdo kohë, dokumentin zyrtar për licencimin e një subjekti dhe veprimtarinë e saj sipas ligjit të zbatueshëm.

“Kodi i Rrjetit” nënkupton Kodin e Rrjetit të Transmetimit të miratuar nga ERE, që është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit, si dhe përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, në përputhje me rregullat e ENTSO-e.

“Rregullator” nënkupton Entin Rregullator të Energjisë (ERE).

“Rrjeti i Transmetimit” nënkupton rrjetin kombëtar të transmetimit të energjisë elektrike siç përcaktohet në Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

“Ndryshim në kontroll” nënkupton çdo shitje, kalim, transferim, ndërprerje, qira, tjetërsim, dhurim, dorëheqje, shkëmbim, ose ndonjë heqje tjetër dorë nga kontrolli.

“Punimet” nënkupton punën që do të kryhet nga përdoruesi ose kontraktori i tij për të realizuar lidhjen në rrjetin e transmetimit.

“Ndërprerje të Programuara të Detyruara” nënkupton çdo ndërprerje të detyruar nga rrethana siç përcaktohen në këtë marrëveshje, të kërkuar nga

OST në përputhje me këtë marrëveshje dhe që amendon ndërprerjet e planifikuara në sistem.

“Ditë pune” nënkupton të gjitha ditët e javës përveç të shtunës, të dielës dhe çdo dite pushimi zyrtar në Republikën e Shqipërisë.

“Qendra Operative e Përdoruesit” nënkupton njësinë organizative të përdoruesit me aftësitë e nevojshme teknike, e cila është ndërfaqja direkte ndërmjet objektit të përdoruesit dhe OST/Qendrës Kombëtare Dispečer.”.

3. Në nenin 3 (Kohëzgjatja e marrëveshjes), të marrëveshjes së lidhjes me rrjetin, shtohet paragrafi nr. 3, si më poshtë:

“3. Në rastin kur OST-ja synon ta përfundojë këtë marrëveshje, njofton ministrinë përgjegjëse për energjisë të paktën 6 (gjashtë muaj) përpara.”.

4. Neni 4 (Deklarime dhe garanci të përdoruesit), i marrëveshjes së lidhjes me rrjetin, ndryshon dhe bëhet:

“Neni 4

Deklarime dhe garanci të përdoruesit

Përdoruesi deklaron dhe garanton OST-në se:

1. Përdoruesi është themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, i regjistruar pranë Regjistrat Tregtar dhe nuk është subjekt i asnjë procedure likuidimi dhe/ose falimentimi.

2. Përdoruesi zotëron ose do të marrë të gjitha autorizimet e nevojshme, me qëllim zbatimin e punimeve që lidhen me ndërtimin, komisionimin dhe vënien në punë të objektit dhe aseteve të lidhjes.

3. Përdoruesi disponon ose do të ketë të gjitha mjetet financiare, teknike dhe teknologjike, me qëllim realizimin e projektit që lidhet me ndërtimin e objektit, aseteve të lidhjes, dhe të të gjitha veprimtarive të tjera që lidhen me mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin në punë nga vetë përdoruesi. Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e aseteve të lidhjes janë në ngarkim të shoqërisë dhe përcaktohen në marrëveshjen e mirëmbajtjes që do të lidhet midis OST sh.a. dhe shoqërisë, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Operimit.

4. Përdoruesi do të zbatojë me përpikmëri të gjitha procedurat dhe rregullat e zbatueshme në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe legjislacionin shqiptar në përgjithësi, për ndërtimin dhe vënien në punë të objektit dhe aseteve të lidhjes.

5. Lidhja dhe zbatimi i kësaj marrëveshje nga ana e përdoruesit nuk përbën asnjë shkelje të ligjit në fuqi në Shqipëri, dokumenteve statutores të



shoqërisë dhe çdo kontratë ose marrëveshje në të cilën përdoruesi është palë.

6. Shoqëria do t'i garantojë dhe sigurojë OST sh.a., përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje, të drejtën e kalimit për të hyrë dhe për të kryer punime në nënstacionin lidhës me rrjetin e transmetimit, të përdoruesit, si dhe në sipërfaqet e tokës ku kalon traseja e linjës lidhëse.

7. Shoqëria do t'i kalojë OST-së në pronësi asetet e lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe do t'i garantojë dhe sigurojë OST sh.a. gëzimin e qetë për të përdorur dhe gëzuar pronën e kaluar, me anë të një kontratë dhurimi. Në këtë rast, pika 3 e këtij neni nuk do të zbatohet për pjesën që lidhet me shpenzimet e mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të aseteve të lidhjes.”.

5. Paragrafi 7, i nenit 6 (Detyrimet e përdoruesit), të marrëveshjes së lidhjes me rrjetin, ndryshon dhe bëhet:

“7. Në rast se përdoruesi kërkon shkëputjen e lidhjes elektrike nga Rrjeti i Transmetimit duhet të njoftojë OST sh.a. 6 muaj përpara dhe shoqëria është e detyruar të mbulojë të gjitha shpenzimet e nevojshme për shkëputjen.”.

6. Neni 8 (Detyrime të OST sh.a.), i marrëveshjes së lidhjes me rrjetin, ndryshon dhe bëhet:

“Neni 8

Detyrime të OST sh.a., i ndryshuar

1. OST sh.a. duhet të:

a) marrë përsipër planifikimet dhe detyrimet përkatëse;

b) marrë në dorëzim Pjesën e Linjës ____ Pjesa e Linjës që do t'i dorëzohet dhe kalojë në pronësi OST-së, fillon tek shtylla nr. ____ deri tek shtylla nr. ____, përfshirë shtyllat, bazamentet dhe sipërfaqet e tokës së bazamenteve të shtyllave [i aplikueshëm kur ka dhurim];

c) brenda një periudhe të arsyeshme nga momenti kur shoqëria ka përmbyshur përcaktimet e bëra në nenin 9 dhe 11, si dhe me një njoftim me shkrim të saj, t'i sigurojë shoqërisë akses në rrjetin e transmetimit, për të mundësuar përfundimin e punimeve duke energjizuar nënstacionin ____.”.

7. Paragrafi 2, i nenit 9 (Dorëzimi i Pjesës së Linjës [i aplikueshëm kur ka dhurim]), të marrëveshjes së lidhjes me rrjetin, ndryshon dhe bëhet:

“2. Kalimi i pronësisë do të bëhet me kontratë dhurimi, ku shoqëria do të dhurojë dhe OST do të pranojë pasuritë e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.”.

8. Paragrafi 2 i nenit 10 (Lidhja me sistemin SCADA, telekomunikacionin dhe komunikimi me Qendrën Kombëtare Dispeçer), i marrëveshjes së lidhjes me rrjetin, ndryshon dhe bëhet:

“10.2. Shoqëria merr përsipër integrimin e të dhënave të nevojshme të nënstacionit të ri për kontroll-monitorimin në sistemin SCADA të Qendrës Kombëtare Dispeçer. Të dhënat e nevojshme për t'u integruar duhet të jenë statuses e çelësave/thikave, alarmet dhe matjet (P, Q, U, I, F) për traktet e tensionit të lartë të linjave dhe transformatorëve të këtij nënstacioni, duke përmbyshur kërkesat e përcaktuara në aneksin nr. 5.”.

9. Neni 13 (Planifikimi i ndërprerjeve dhe de-energizimi), i marrëveshjes së lidhjes me rrjetin, ndryshon si më poshtë:

“Neni 13

Planifikimi i ndërprerjeve dhe de-energizimi

1. Bazuar në procedurat e përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit, Operatori i Sistemit lejohet të kryejë menaxhimin e drejtë të situatave teknike në sistemin elektroenergjetik, duke marrë në konsideratë një gamë të gjerë kushtesh operacionale, në rrethana normale dhe jo normale, në kushtet e tanishme dhe të një sistemi në të ardhmen. Në Kodin e Rrjetit nuk mund të parashikohen dhe adresohen të gjitha mundësitë operacionale, prandaj OST sh.a., në rrethana të paparashikuara në Kod, mund të veprojë vendosmërisht në zbatim të detyrimeve të saj.

2. OST sh.a. dhe përdoruesi duhet të koordinojnë ndërprerjet e planifikuara në rrjet, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit, në atë masë që është praktikisht e mundshme dhe arsyeshme.

3. OST sh.a. dhe përdoruesi do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që ndërprerjet e tilla do të jenë me kohëzgjatje minimale dhe do të shkaktojnë shqetësime minimale për të tretët dhe nuk do të dëmtojnë funksionimin e sigurt dhe të besueshëm të sistemit.

4. Pavarësisht nga planifikimi vjetor i ndërprerjeve, OST sh.a. do të mund të kryejë



ndërprerje të programuara të detyruara dhe de-energizim të pikës së lidhjes së përdoruesit, kur kjo kërkohet me qëllim ushtrimin e funksioneve të saj, me kushtin që të njoftojë këtë të fundit 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara ditës së kryerjes së ndërprerjeve, për ndryshimin e planit të ndërprerjeve dhe për kryerjen e ndërprerjeve të programuara të detyruara, sipas rastit, ku njoftime të tilla do të jenë në përputhje me paragrafin 5 më poshtë.

5. Njoftimi i OST sh.a. do të përfshijë:

- a) njoftimin dhe arsyetimin;
- b) planin e ndërprerjeve, të përditësuar;
- c) ndërprerjen e programuar të detyruar duke specifikuar numrin e pritshëm të ndërprerjeve, kohëzgjatjen në orë dhe datat për secilën pikë lidhje ku kryhet ndërprerja.

6. Nëse përdoruesi pengon OST sh.a. në kryerjen e ndërprerjeve të programuara të detyruara, bëhet përgjegjës për të gjitha pasojat dhe kostot që lidhen me vonesat dhe që mund t'i shkaktohen OST sh.a. apo të tretëve me të cilët OST sh.a. është në marrëdhënie kontraktuale.

7. OST sh.a. do të ushtrojë të drejtën e de-energizimit të përdoruesit në çdo kohë dhe në afatet dhe masën që OST sh.a. e vlerëson proporcionale me situatën, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit, ose në ndonjë nga rrethanat e mëposhtme:

- a) në kushtet e Forcës Madhore, kur konsiderohet se rrethanat e kërkojnë një masë të tillë;
- b) për qëllim të realizimit të projekteve për fuqizimin e rrjetit të transmetimit, duke i dërguar njoftim me shkrim përdoruesit, të paktën 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara;
- c) për qëllim të realizimit të lidhjeve të reja të të tretëve në rrjetin e transmetimit, duke i dërguar njoftim me shkrim përdoruesit të paktën 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara;
- d) me qëllim gjetjen dhe eliminimin e një defekti, për mirëmbajtjen, riparimin, ose testimin e një pjese të rrjetit, të cilat janë të nevojshme për të siguruar funksionimin normal dhe për të fuqizuar sigurinë operacionale të rrjetit, duke i dërguar njoftim me shkrim përdoruesit, brenda një afati që është praktikisht i mundur dhe i arsyeshëm për OST-në;
- e) nëse është e nevojshme në një situatë emergjence në afërsi të rrjetit elektrik, ose në rast nevojë për të zbutur efektet e çdo rreziku material ose humbjeje financiare për çdo person apo prone të lidhur me ose pranë rrjetit;

f) kur kërkohet nga furnizuesi i përdoruesit, për mospagesë të furnizimit me energji elektrike. Në një rrethanë të tillë, OST-ja mund të kërkojë dëshmi të mospagesës nga përdoruesi;

g) kur përdoruesi nuk përmbush detyrimet në bazë të Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe sipas vlerësimit të OST sh.a. kjo ka një efekt material të dëmshëm në rrjet;

h) në funksion të nenit 7 “Ushtrimi i të drejtave” të Marrëveshjes së Operimit, nga momenti që është nënshkruar dhe e zbatueshme për palët e kësaj marrëveshjeje;

i) nëse marrëveshja mes palëve përfundon;

j) pas njoftimit me shkrim 7 (shtatë) ditësh kalendarike përpara, nëse nuk ka dakordësi midis palëve për ndryshime në rrjetin e përdoruesit (shtesë fuqi, rikonfigurim, etj.);

k) nëse gjatë kryerjes së punimeve ose gjatë operimit të aseteve të lidhjes, bazuar në një opinion të arsyeshëm të secilës palë, kushtet ose mënyra e veprimit të rrjetit të transmetimit, ose në rast se pjesa e linjës ose nënstacioni shfaq një kërcënim të menjëhershëm për plagosje ose dëme materiale ndaj ndonjë personi, ose rrjetit të transmetimit, ose vetë nënstacionit, OST sh.a. mund të urdhërojë, sipas rastit, personelin operativ të nënstacionit të de-energizojë menjëherë pjesën e linjës dhe nënstacionin ose OST sh.a. mund të de-energizojë pjesë të rrjetit të transmetimit, në çdo rast, duke iu përmbajtur Kodit të Rrjetit të Transmetimit, nëse është e nevojshme ose e përshtatshme për të shmangur shfaqjen e këtyre plagosjeve ose dëmeve.

8. Në rastet e de-energizimit të një përdoruesi, OST sh.a. do të dokumentojë dhe publikojë shpenzimet që lidhen me de-energizimin dhe do t'i faturojë përdoruesit këto shpenzime kur:

- a) de-energizimi është bërë me kërkesën e përdoruesit;
- b) de-energizimi është bërë në kushtet e nenit 28 të Marrëveshjes së Operimit, nga momenti që është nënshkruar dhe e zbatueshme për palët e kësaj Marrëveshjeje dhe përdoruesi ka qenë shkaktar për nevojën e de-energizimit;
- c) kur de-energizimi është bërë për shkak të shkeljes nga përdoruesi të Kodit të Rrjetit të Transmetimit apo kësaj Marrëveshjeje të Lidhjes, Marrëveshjes së Operimit dhe Marrëveshjes së Mirëmbajtjes (nëse është e zbatueshme);
- d) kostot e shkaktuara nga de-energizimi duhet të dokumentohen dhe publikohen.



9. Kur de-energizimi kërkohet nga furnizuesi i përdoruesit, OST sh.a. do t'i faturojë shpenzimet në lidhje me de-energizimin, furnizuesit të përdoruesit.

10. Pa cenuar detyrimet e tjera të kësaj marrëveshjeje, OST sh.a. do të rienergizojë sa më parë që të jetë e mundur përdoruesin kur ka të dhëna që rrethanat që çuan në de-energizim nuk ekzistojnë më apo ka garanci të dokumentuar që rrethanat nuk do të përsëriten.

11. OST sh.a. mund të kërkojë nga përdoruesi i prekur nga de-energizimi prova të arsyeshme ose kryerjen e testeve, për të verifikuar që shkaqet e de-energizimit janë adresuar apo nuk ekzistojnë më. Testimet e nevojshme mund të realizohen nga ana e vetë përdoruesit, nga të tretë ose do të lejohet të kryhet nga OST.

12. Kur verifikimi apo testimet kryhen nga OST sh.a., përdoruesi do të jetë përgjegjës për mbulimin e kostove përkatëse.

13. Rienergizimi do të kryhet me koordinimin e të dyja palëve duke garantuar sigurinë e operimit të Rrjetit të Transmetimit dhe shmangur efektet shqetësuese për të tretët.

14. Kostot për rienergizimin alokohen në të njëjtën mënyrë si kostot e de-energizimit.

15. Nëse, gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje përdoruesi nuk është në gjendje të livrojë energjinë e prodhuar si pasojë e një ngjarjeje të ndërprerjes, atëherë OST sh.a. duhet të dëmshpërblejë përdoruesin, sipas legjislacionit në fuqi.

16. OST sh.a., në çdo rast, do të dokumentojë dhe publikojë kostot e shkaktuara si pasojë e një ngjarjeje të ndërprerjes, si dhe do të publikojë kompensimet si pasojë e një ngjarjeje të de-energizimi.”.

10. Paragrafi 1, i nenit 19 (Konfidencialiteti), i marrëveshjes së lidhjes me rrjetin, ndryshon si më poshtë:

“1. Secila nga palët merr përsipër që të ruajë sekret përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje dhe kushtet e saj, si dhe çdo informacion dhe dokument që palët kanë shkëmbyer ose kanë marrë dijeni gjatë negociimeve të kësaj marrëveshjeje, me përjashtim të rasteve kur bërja publike e sa më sipër është kërkesë e ligjeve shqiptare ose e institucioneve financiare të përdoruesit (nëse ka) (duke përfshirë filialet e tyre, punonjësit, këshilltarët dhe çdo palë tjetër të lidhur), me kusht që këto institucione financiare pajtohen me detyrimet e konfidencialitetit.”.

11. Neni 23 (Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve), i marrëveshjes së lidhjes me rrjetin, ndryshon si më poshtë

“Neni 23

Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kjo marrëveshje është hartuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me të.

2. Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin si pasojë e interpretimit dhe zbatimit të kësaj marrëveshjeje, kur kanë të bëjnë me interpretimin e dispozitave të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, do të zgjidhen në përputhje me procedurat e parashikuara në të. Në çdo rast tjetër, palët do të mundohen t'i zgjidhin mosmarrëveshjet me mirëkuptim midis tyre.

3. Në rast se palët nuk e kanë zgjidhur me mirëkuptim mosmarrëveshjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike, secila palë mund ta dërgojë këtë mosmarrëveshje për zgjidhje tek ERE.

4. Në rast se mosmarrëveshja nuk është zgjidhur nga ERE, secila palë ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”.

VENDIM

Nr. 319, datë 12.12.2022

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BALKAN ENERGY TRADE” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar



me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2039/6 prot., datë 7.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Balkan Energy Trade’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

-Shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2015 prot., datë 30.11.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të aneksi A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

-Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të rregullores për nenin 9, pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a” dhe “d” dhe pikën 2.5.

- Nga ky aplikim rezultojnë mungesa në dokumentacionin si më poshtë:

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: aplikuesi nuk ka përcjellë vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj;

- germa “c”: aplikuesi nuk ka përcjellë informacion në lidhje me parashikimin për shtimin e stafit sipas planit të biznesit dhe nëse në strukturën e shoqërisë do të integrohet edhe staf teknik i cili do të kujdeset për tregtimin e energjisë elektrike, duke qenë se aktualisht stafi i deklaruar përbëhet vetëm nga administratori. Sa më sipër depozituar, struktura e shoqërisë vlerësohet e pa plotë.

- Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “a”: shoqëria nuk ka përcjellë vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore;

- germa “b”: në vijim të depozitimit të bilanceve për periudhën aktive të shoqërisë, konstatohet se kjo e fundit nuk ka depozituar dokumentacion në kuadër të mbështetjes financiare, ndaj vlerësohet t’i kërkohej që të depozitojë dokumentacionin referuar vlerës së investimit bazuar në planin e biznesit;

- germa “c”: në vijim shoqëria për llogaritjen e mbështetjes financiare ku të ketë garantuar të paktën një muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi nuk i është referuar çmimit të bursës, për parashikimin vjetor të kostove. Gjithashtu në planin e biznesit nuk përcaktohet mënyra sesi kjo e fundit do të mbulojë financiarisht këtë plan.

- Në kuadër të mos plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet mosfillimi i procedurës për këtë aplikim.

- Në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në rast se shoqëria, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijani e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet në ERE dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Në rast se shoqëria brenda 1 (një) muaji nga marrja dijani e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet në ERE dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 27, datë 7.8.2023

PËR SHPALLJEN E REZULTATIT
PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE, PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE,
TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të nenit 20, pikat 2, shkronja “d”, e 3, dhe nenit 167, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023, si më poshtë:

a) rezultatin e votimit për kandidatët për kryetar bashkie, të cilët janë zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë në zonën zgjedhore përkatëse, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) numrin e votave të fituara nga secili subjekt në shkallë kombëtare, bazuar në numrin e votave të fituara nga çdo subjekt zgjedhor në votimin për këshillat e qeverisjes vendore, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Kryetar: Ilirjana Nano

Anëtarë: Arens Çela, Dritan Çaka, Helga Vukaj
(në mungesë), Muharrem Çakaj (kundër)



Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2023

Lidhja Nr. 1

Kandidatët fitues për kryetar bashkie

Qarku Berat

Nr.	Bashkia	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti propozues
1	Berat	Ervin	Zehni	Demo	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	Dimal	Juliana	Flamur	Memaj	Partia Socialiste e Shqipërisë
3	Kuçovë	Kreshnik	Rlza	Hajdari	Partia Socialiste e Shqipërisë
4	Poliçan	Adriatik	Maliq	Zotkaj	Partia Socialiste e Shqipërisë
5	Skrapar	Adriatik	Maliq	Mema	Partia Socialiste e Shqipërisë

Qarku Dibër

Nr.	Bashkia	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti propozues
1	Bulqizë	Festime	Halil	Mjeshtri	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	Dibër	Rahim	Petrit	Spahiu	Partia Socialiste e Shqipërisë
3	Klos	Valbona	Zyber	Kola	Partia Socialiste e Shqipërisë
4	Mat	Agron	Rufat	Malaj	Partia Socialiste e Shqipërisë

Qarku Durrës

Nr.	Bashkia	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti propozues
1	Durrës	Emiriana	Hiqmet	Sako	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	Krujë	Artur	Xheke	Bushi	Partia Socialiste e Shqipërisë
3	Shijak	Elton	Xhemal	Arbana	Partia Socialiste e Shqipërisë

Qarku Elbasan

Nr.	Bashkia	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti propozues
1	Belsh	Arif	Faik	Tafari	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	Cërrik	Andis	Gëzim	Salla	Partia Socialiste e Shqipërisë
3	Elbasan	Gledian	Iljaz	Llatja	Partia Socialiste e Shqipërisë
4	Gramsh	Besion	Gëzim	Ajazi	Partia Socialiste e Shqipërisë
5	Librazhd	Mariglen	Hasan	Disha	Partia Socialiste e Shqipërisë
6	Peqin	Bukurosh	Izet	Maçi	Partia Socialiste e Shqipërisë
7	Prrenjas	Nuri	Ramiz	Belba	Partia Socialiste e Shqipërisë

Qarku Fier

Nr.	Bashkia	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti propozues
1	Divjakë	Josif	Vangjel	Gorrea	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	Fier	Armando	Nikolla	Subashi	Partia Socialiste e Shqipërisë



Nr.	Bashkia	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti propozues
3	Lushnje	Eriselda	Musa	Sefa	Partia Socialiste e Shqipërisë
4	Mallakastër	Qerim	Ismail	Ismailaj	Partia Socialiste e Shqipërisë
5	Patos	Fation	Kristaq	Duro	Partia Socialiste e Shqipërisë
6	Roskovec	Majlinda	Daut	Bufi	Partia Socialiste e Shqipërisë

Qarku Gjirokastrë

Nr.	Bashkia	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti propozues
1	Dropull	Dhimitraq	Pandeli	Toli	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	Gjirokastrë	Flamur	Sejdi	Golemi	Partia Socialiste e Shqipërisë
3	Këlcyrë	Klement	Petro	Ndoni	Partia Socialiste e Shqipërisë
4	Libohovë	Leonard	Vyrtyt	Hide	Partia Socialiste e Shqipërisë
5	Memaliaj	Albert	Abedin	Malaj	Bashke Fitojme
6	Përmet	Alma	Hasan	Hoxha	Partia Socialiste e Shqipërisë
7	Tepelenë	Tërmet	Nuro	Peçi	Partia Socialiste e Shqipërisë

Qarku Korçë

Nr.	Bashkia	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti propozues
1	Devoll	Eduard	Gazi	Duro	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	Kolonjë	Erion	Adriatik	Isai	Partia Socialiste e Shqipërisë
3	Korçë	Sotiraq	Melka	Filo	Partia Socialiste e Shqipërisë
4	Maliq	Gezim	Ali	Topçiu	Partia Socialiste e Shqipërisë
5	Pogradec	Ilir	Telha	Xhakolli	Partia Socialiste e Shqipërisë
6	Pustec	Pali	Andon	Kolefski	Partia Socialiste e Shqipërisë

Qarku Kukës

Nr.	Bashkia	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti propozues
1	Has	Miftar	Tahir	Dauti	Bashke Fitojme
2	Kukës	Safet	Nebi	Gjici	Partia Socialiste e Shqipërisë
3	Tropojë	Rexhe	Uke	Byberi	Partia Socialiste e Shqipërisë

Qarku Lezhë

Nr.	Bashkia	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti propozues
1	Kurbin	Majlinda	Pashk	Cara	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	Lezhë	Pjerin	Zef	Ndreu	Partia Socialiste e Shqipërisë
3	Mirditë	Albert	Dod	Mëlyshi	Bashke Fitojme



Qarku Shkodër

Nr.	Bashkia	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti propozues
1	Fushë-Arrëz	Hil	Zek	Curri	Bashke Fitojme
2	Malësi e Madhe	Tonin	Zef	Marinaj	Partia Socialiste e Shqipërisë
3	Pukë	Rrok	Ndrec	Dodaj	Bashke Fitojme
4	Shkodër	Benet	Bahri	Beci	Partia Socialiste e Shqipërisë
5	Vau-Dejës	Kristian	Luigj	Shkreli	Partia Socialiste e Shqipërisë

Qarku Tiranë

Nr.	Bashkia	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti propozues
1	Kamëz	Rakip	Bajram	Suli	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	Kavajë	Fisnik	Ymer	Qosja	Bashke Fitojme
3	Rrogozhinë	Edison	Selman	Memolla	Partia Socialiste e Shqipërisë
4	Tiranë	Erion	Luan	Veliaj	Partia Socialiste e Shqipërisë
5	Vorë	Blerim	Rustem	Shera	Partia Socialiste e Shqipërisë

Qarku Vlorë

Nr.	Bashkia	Emri	Atësia	Mbiemri	Subjekti propozues
1	Delvinë	Besmir	Nexhip	Veli	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	Finiq	Romeo	Kosta	Çakuli	Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen
3	Himarë	Dhionisios Alfred	Petro	Belieri	Bashke Fitojme
4	Konispol	Ergest	Ladimir	Dule	Partia Socialiste e Shqipërisë
5	Sarandë	Oltion	Ahmet	Çaçi	Partia Socialiste e Shqipërisë
6	Selenicë	Nertil	Engjëll	Bellaj	Partia Socialiste e Shqipërisë
7	Vlorë	Ermal	Neki	Dredha	Partia Socialiste e Shqipërisë



Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2023

Lidhja Nr. 2

**NUMRI I VOTAVE TË FITUAR NGA SECILI SUBJEKT NË SHKALLË KOMBËTARE, BAZUAR NË
REZULTATIN E VOTAVE TË FITUARA NGA ÇDO SUBJEKT ZGJEDHOR NË VOTIMIN PËR
KËSHILLAT E QEVERISJES VENDORE**

Nr	Subjektet zgjedhor		Vota të fituara	
			Gjithsej	Përqind
1	Partia Socialiste e Shqipërisë	PS	579.625	43,11%
2	Bashkë Fitojmë	BF	247.883	18,44%
3	Partia Demokratike	PDSH	103.723	7,71%
4	Partia Socialdemokrate	PSD	86.283	6,42%
5	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	P.A.A	44.047	3,28%
6	Partia Republikane Shqiptare	PR	32.071	2,39%
7	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	P.D.I.U	28.978	2,16%
8	Partia Levizja e Legalitetit	PLL	23.683	1,76%
9	Aleanca Progresiste L.ZH.K	LZHK	22.906	1,70%
10	Partia Demokracia Sociale	P.D.S	21.798	1,62%
11	Fryma e Re Demokratike	FRD	18.459	1,37%
12	Aleanca Liberale e Djathtë	ALD	16.859	1,25%
13	Partia e Gjellbër	P.GJ	16.326	1,21%
14	Aleanca Arbnore Kombëtare	AAK	11.680	0,87%
15	Nisma Thurje	NTH	10.804	0,80%
16	Partia Balli Kombëtar	P.B.K	7.611	0,57%
17	Lëvizja Bashkë	BASHKE	7.539	0,56%
18	Ardhmëria Shqiptare	PASH	6.963	0,52%
19	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	ADK	6.373	0,47%
20	Partia Kristian Demokrate	PKDSH	6.211	0,46%
21	Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë	AD	6.131	0,46%
22	Partia Unitetit Kombëtar	PUK	5.593	0,42%
23	Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	ADS	4.647	0,35%
24	Bindja Demokratike	BD	4.226	0,31%
25	Partia Konservatore	KONS	2.767	0,21%
26	Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	MEGA	2.275	0,17%
27	Partia Kombëtare Konservatore Albania	PKKA	1.881	0,14%
28	Partia Ora e Shqipërisë	P.O.SH	1.455	0,11%
29	Partia e Reformave Demokratike Shqiptare	P.R.D.Sh	1.383	0,10%
30	Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane	ABDE	1.125	0,08%
31	Lëvizja e RE	LRE	966	0,07%
32	Partia Komuniste e Shqipërisë	PKSH	915	0,07%
33	Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve	P.M.D.E	886	0,07%
34	Partia për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë	PEISH	801	0,06%
35	Partia Mbrojtjen e të Drejtave të Puntorve të Shqipërisë	P.M.D.P.SH	671	0,05%
36	Lëvizja punëtore Shqiptare	P.L.P.SH	546	0,04%
37	Aleanca Maqedonasve për integrimin Europian	A.M.I.E	439	0,03%
38	Partia Emigracionit Shqiptar	P.E.Sh	317	0,02%
39	Fronti i Majtë	FM	270	0,02%
40	Lidhja Demokristiane Shqiptare	L.D.K	216	0,02%
41	Diogjen Kolici	Kandidat i propozuar nga zgjedhësit	1.245	0,09%
42	Astrit Ademi	Kandidat i propozuar nga zgjedhësit	938	0,07%
43	Festim Kaso	Kandidat i propozuar nga zgjedhësit	938	0,07%
44	Lazjon Petri	Kandidat i propozuar nga zgjedhësit	813	0,06%
45	Rinaldo Piroli	Kandidat i propozuar nga zgjedhësit	698	0,05%
46	Ibrahim Bajrami	Kandidat i propozuar nga zgjedhësit	680	0,05%
47	Mitat Daja	Kandidat i propozuar nga zgjedhësit	666	0,05%
48	Agim Hysa	Kandidat i propozuar nga zgjedhësit	588	0,04%
49	Fatjon Biba	Kandidat i propozuar nga zgjedhësit	308	0,02%
50	Soraldo Nebo	Kandidat i propozuar nga zgjedhësit	291	0,02%
Gjithsej vota të vlefshme			1.344.497	100%

**KORRIGJIM GABIMI**

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 27.3.2023, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s n. 150, datë 10.6.2022, ‘Mbi miratimin e Zyrtarit të Pajtueshmërisë të ‘Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)’ sh.a.’”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 4.5.2023, bëhet korrigjimi, si më poshtë:

Pika 4 e konstatimeve ndryshon dhe bëhet:

“Zyrtari i Pajtueshmërisë, i miratuar nga organet drejtuese të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., rezulton të jetë z. Ervis Hazizi”.

Pika 5 e konstatimeve ndryshon dhe bëhet:

“Shoqëria ka depozituar në ERE dhe kontratën e nënshkruar mes ZP-së të përzgjedhur, z. Hazizi, dhe OSSH sh.a. ...”.

Pika 7 e konstatimeve ndryshon dhe bëhet:

“Zyrtari i Pajtueshmërisë z. Ervis Hazizi, i propozuar nga shoqëria OSSH sh.a., i ka përmbushur kriteret e sipërcituara ...”.

Pika 1 e dispozitivit ndryshon dhe bëhet:

“1. Të miratojë emërimin e z. Ervis Hazizi si Zyrtar i Pajtueshmërisë të “Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., për një mandat 3-(tre-)vjeçar.”.

Pika 2 e dispozitivit ndryshon dhe bëhet:

“2. Efektet e kontratës së nënshkruar mes shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. dhe z. Hazizi fillojnë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.”.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë